

## **R E L A C I O N**

### **PËR**

#### **PROJEKTAKTIN NORMATIV “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8402, DATË 10.9.1998, “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, Vendimi Nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ, kërkohet të plotësohen kushtet, si më poshtë vijon:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

- **Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, paraqitet nevoja urgjente për ndërhyrje me akt normativ për shkak të situatës aktuale lidhur me ndërtimet pa leje.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në formën e akteve normative paraqet një domosdoshmëri urgjente, për shkak të situatave të krijuara në territor nga ndërtimet pa leje, zënia dhe abuzimi me hapësirat publike, si dhe mungesa e mekanizmave të qartë për mbrojtjen e interesit qytetar. Prej vitesh, hapësira të konsiderueshme publike janë zënë në mënyrë të paligjshme ose janë keqpërdorur, duke e kufizuar aksesin e qytetarëve në mjedise të përbashkëta që ligjërisht u përkasin atyre.

Ky fenomen ka sjellë pasoja serioze për cilësinë e jetës urbane, duke dëmtuar jo vetëm estetikisht qytetet, por duke ulur edhe standardin e shërbimeve publike. Ndryshimet ligjore që propozohet të miratohen me akte normative synojnë:

- Lirimin e menjëhershëm të hapësirave publike, duke i kthyer ato në funksion të qytetarëve dhe komunitetit.
- Ndalimin efektiv të ndërtimit pa leje, përmes forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve të qarta.
- Rikthimin e territorit në një ambient të shfrytëzueshëm dhe të rregullt, në përputhje me planet urbanistike dhe projektet e miratuara zyrtarisht.

Ky proces nuk ka vetëm rëndësi juridike e urbanistike, por edhe impakt të drejtpërdrejtë ekonomik e social. Lirimi i hapësirave publike dhe rikthimi i tyre në shërbim të komunitetit krijon mundësi për zhvillimin e turizmit, rrit atraktivitetin e zonave urbane dhe bregdetare, dhe kontribuon në krijimin e një imazhi pozitiv për vendin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një kohë kur turizmi po shndërrohet në një nga sektorët kryesorë të ekonomisë kombëtare, duke gjeneruar të ardhura dhe punësim. Për këto arsye, miratimi i ndryshimeve si akte normative është i domosdoshëm dhe i menjëhershëm, pasi siguron reagim të shpejtë ndaj situatave të paligjshmërisë dhe i kthen hapësirat publike në funksion të qytetarëve, duke mbrojtur interesin publik, duke forcuar sundimin e ligjit dhe duke krijuar baza të qëndrueshme për zhvillim e territorit dhe atij turistik.

Gjithashtu ky akt normativ propozohet edhe për shkak të abuzimeve të larta me mosrespektimin e projekteve arkitektonike dhe shkeljen e hapësirave publike duke e bërë emergjente ndërhyrjen me ndryshimet e propozuara në ligj.

## **- Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ, me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

Ndryshimet e propozuara synojnë harmonizimin e ligjit ekzistues Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me ndryshimet e bëra në Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Ndryshimi i propozuar në këtë projektakt normativ vjen si nevojë për të adresuar mangësi të evidentuara gjatë zbatimit të punimeve ndërtimore dhe për të garantuar transparencë, përgjegjshmëri dhe siguri më të lartë në procesin e zhvillimit të territorit.

Në thelb, ndryshimet synojnë:

1. Përcaktime më të qarta mbi fazat e kontrollit – duke i ndarë qartë fazat e kontrollit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve, me qëllim shmangien e abuzimeve dhe devijimeve nga projektet e miratuara.
2. Formalizimin e mënyrës së njoftimit – duke vendosur rregulla të detajuara për njoftimin e institucioneve përgjegjëse dhe autoriteteve mbikëqyrëse përpara fillimit të çdo lloj punimi, në mënyrë që procesi të jetë i gjurmueshëm dhe i dokumentuar.
3. Rritjen e garancisë së zbatimit të projekteve arkitekturore – përmes përfshirjes detyruese të arkitektëve të projektit në procesin e mbikëqyrjes, duke garantuar që punimet të kryhen sipas standardeve dhe projekteve të miratuara zyrtarisht, si dhe duke minimizuar shmangien nga projektet e miratuara.

Ky ndryshim ligjor synon të forcojë disiplinën ndërtimore, të rrisë cilësinë e projekteve dhe të sigurojë respektimin e të gjitha standardeve teknike e urbanistike, duke mbrojtur interesin publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Duke marrë parasysh problematikat e hasura gjatë zbatimit të projekteve të miratuara nga organet e zhvillimit gjatë zbatimit të punimeve si dhe duke pasur parasysh nismën e ndërmarrë për minimizimin e ndërtimeve pa leje ky projekt ligj i cili ka si qëllim rritjen e përgjegjësisë së zhvilluesit dhe të mbikqyrësve gjatë procesit të zbatimit të punimeve, përfshirjen e arkitektit gjatë zbatimit të projektit duke siguruar përputhshmërinë e projekt të zbatuar me atë të miratuar, forcimin e mekanizmave të kontrollit teknik dhe ligjor gjatë fazave të ndërtimit, saktësimin e autoriteve inspektuese duke përfshirë dhe Sekretariatit Teknik të KKTU-së për lejet në kompetencë të KKTU, harmonizimin e rolit të institucioneve vendore dhe qëndrore gjatë procesit të inspektimit, si dhe sanksionimin e lidhjes së njësive individuale me rrjetet e ujit dhe energjisë elektrike vetëm pas pajisjes së objektit me certifikatën e përdorimit.

## **I. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt normativ është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave për zhvillimin e territorit.

## **II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT, LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektakt normativ vjen si domosdoshmëri për të përmirësuar procesin e zhvillimit të territorit, që vjen si rezultat i harmonizimit me ndryshimet në legjislacionin në fuqi për zhvillimin e territorit, në kuadër të minimizimit të ndërtimeve pa leje, forcimin e mekanizmave të kontrollit teknik dhe ligjor, duke përforcuar aktete e kontrollit sipas fazave dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas secilës fazë. Në këtë projekt ligj është përcaktuar rritja e përgjegjësisë së aktitektit duke e përfshirë në procesin e zbatimit të projektit arkitektonik të miratuar. Arkitekti

me ndryshimet e propozuara kontrollon përputhshmërinë e projektit arkitektonik, dhe mban raporte gjatë tre fazave të abatimit të projektit sipas kalendarit të punimeve.

Gjithashtu, me ndryshimet e propozuara zhvilluesi/zbatuesi i punimeve detyrohet të njoftojë përvec organeve vendore dhe inspektoriateve, edhe Sekretariatit Teknik të KKTU-së për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU – së.

Me anën e këtij projektligji përcaktohen faza të detajuara kontrolli që nga ngritja e kantierit, përfundimin e themeleve, karabinasë, instalimeve deri tek rifiniturat e jashtme. Gjithashtu është përcaktua që këto akte kontrolli të depozitohen në sistemin elektronik e-leje sëbashku me deklaratat e përgjegjësisë, duke bërë të mundur ndërhyrjen me të shpejtë në rastet e shkeljeve, si dhe korrigjimin/ndryshimin e projektit në përputhje me lejen e miratuar në kohë reale.

Një ndryshim thelbësor është parashikuar edhe në lidhje me proceduart e pajisjes me çertifikatë përdorimi, duke minimizuar funksionimin e objekteve pa kolaudim, si dhe parandalon rritjen e ndërtimeve pa leje, duke e lidhur këtë procedurë ngushtë me furnizimin me rrjetin e ujit dhe energjisë elektrike.

Të gjitha këto ndryshimeve do të sjellin forcimin e bazës ligjore në uljen e ndërtimeve pa leje, respektimin e projekteve arkitektonike të miratuara, bashkëpunimin ndërinstucional, si dhe kanë një ndikim në interesin publik, duke garantuar siguri tek blerësit në objektet e pajisura me leje ndërtimi.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Ky projektakt normativ që prozohet del në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projekt-akti nuk ka përputhshmëri me *acquis communautaire*.

---

Relacion “Për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar

## **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

### **NENI 1**

*Në nenin 3, “Përkufizime”, pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:*

*14. “Zhvillues” është çdo person fizik ose juridik, që investon dhe realizon një zhvillim sipas lejes së miratuar nga organi përgjegjës.*

### **NENI 2**

*Në Nenin 7, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:*

*“7. Mbikëqyrësit/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i shtohet në çdo rast arkitekti, i cili ka hartuar projektin ose një arkitekt i përzgjedhur nga zhvilluesi.*

### **NENI 3**

*Në Nenin 7/1 “Përgjegjësia e mbikëqyrësit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:*

- në pikën “1”, togfjalëshi “Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë”, zëvendësohet me togfjalëshin “autoritetin përgjegjës të inspektimit dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU”.*
- në pikën “2”, togfjalëshi “autoritetin përgjegjës së planifikimit” ndryshohet me togfjalëshin “autoritetin përgjegjës së zhvillimit”*
- në pikën “4”, togfjalëshi “autoriteti përgjegjës i planifikimit” ndryshohet me togfjalëshin “autoriteti përgjegjës i zhvillimit”*

### **NENI 4**

*Pas nenit 7/1, shtohet neni 7/2 me këtë përmbajtje:*

*“Neni 7/2*

*Përgjegjësia e arkitektit*

*1. Gjatë zbatimit të punimeve, arkitekti i përzgjedhur nga zhvilluesi, në përputhje me pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji, është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin arkitektonik të miratuar me lejen e ndërtimit.*

2. Arkitekti i përzgjedhur nga zhvilluesi harton dhe mban një raport mbi zbatimin e punimeve në përputhje me projektin arkitektonik të miratuar, në bazë të kalendarit të punimeve, në 3 faza të zbatimit të projektit, të përcaktuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 10/1 të këtij ligji..

3. Në çdo rast, kur gjatë kontrollit të zbatimit të punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me projektin arkitektonik të miratuar me lejen e ndërtimit, njofton menjëherë mbikqyrësin, autoritetin përgjegjës të inspektimit dhe autoritetin përgjegjës të zhvillimit të territorit.”

#### **NENI 5**

*Në Nenin 8, pika “6”, pas togfjalëshit “Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, shtohet togfjalëshi “dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU”.*

#### **NENI 6**

*Në Nenin 8/1 “Drejtuesi teknik”, në pikën 2, pas togfjalëshit “Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit”, shtohet togfjalëshi “dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU”.*

#### **NENI 7**

*Neni 9 ndryshohet me përmbajtje si vijon si më poshtë:*

*“Njoftimi për fillimin e punimeve”*

1. “Zhvilluesi ose zbatuesi i punimeve, përpara fillimit të punimeve, duhet të njoftojë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit seksionin e urbanistikës pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë, si dhe Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, policinë e shtetit dhe Sekretariatin Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU.

2. Në njoftim jepen të dhëna për objektin, zhvilluesin, zbatuesin e punimeve, subjektin mbikëqyrës dhe arkitektin.

3. Subjekti së bashku me njoftimin depoziton:

a) lejen e ndërtimit, së bashku me planin e vendosjes së objektit dhe projektin e zbatimit të miratuar nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit;

b) planin e ngritjes dhe të organizimit të kantierit.

4. Me depozitim të njoftimit sipas përcaktimeve të këtij neni, zhvilluesi ose zbatuesi i punimeve mund të fillojnë punimet e ndërtimit.
5. Inspektoriati përgjegjës dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për lejet në kompetencë të KKTU, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të dosjes, duhet të njoftojë subjektin për plotësimin ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur.
6. Subjekti duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti përgjegjës, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.
7. Zhvilluesi apo zbatuesi i punimeve, detyrimisht në çdo rast, njofton brenda 10 ditëve, autoritetin përgjegjës që ka lëshuar lejen e ndërtimit në sistemin e-leje për kontrollin e punimeve menjëherë sipas fazave të kontrollit me piketimin e objektit, me përfundimin e punimeve në kuotën  $\pm 0,00$  dhe në përfundim të karabinasë.

## **NENI 8**

Neni 10 ndryshohet me përmbajtje si vijon si më poshtë:

*“Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet dhe grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve. Dokumentacioni përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.”*

## **NENI 9**

Pas Nenit 10, shtohet Neni 10/1, si më poshtë vijon:

*“Aktet e kontrollit”*

1. Aktet e kontrollit për proceset e ndërtimit nga subjektet, persona fizikë dhe juridikë, të pajisur me licencë në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, mbahen sipas fazave të mëposhtme:
  - a) ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë rrethimin e kantierit;
  - b) piketimi i strukturës ose veprave të infrastrukturës;
  - c) përfundimi i themeleve / kuota 0;
  - d) ç) përfundimi i karabinasë së objektit;
  - e) përfundimet e instalimeve elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike dhe të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, të komunikimit elektronik, përfshirë pikën e aksesit në godina sipas përcaktimeve të legjislacioni në fuqi.
  - f) dh) përfundimi i fasadave, rifiniturave dhe sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë dhe vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.

2. Aktet e kontrollit të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, janë të detyrueshme të depozitohen on-line në sistemin e-leje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe sekretariatit teknik të KKTU-së në rastet në kompetencë të KKTU-së, të shoqëruara me një deklaratë përgjegjësie, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar, për çdo fazë ndërtimi. Njësia e vetëqeverisjes vendore, në çdo rast për të gjitha lejet, ka detyrimin të verifikojë punimet e zbatimit nëpërmjet kontrollit fizik të detyrueshëm në terren, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “dh” të pikës 1, të këtij neni.

3. Sekretariati Teknik i KKTU, mund të kryejë monitorimin e procesit të punimeve të ndërtimit, pasi të ketë vlerësuar situatën rast pas rasti, në varësi të kompleksitetit që mund të paraqesë projekti i miratuar nga KKTU.

4. Aktet e kontrollit të refuzuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas çdo faze punimi zbatimi, në çdo rast duhet t’i njoftohen brenda 15 ditëve inspektoratit qendror apo vendor përgjegjës për kontrollin e territorit dhe sekretariatit teknik të KKTU-së, për rastet në kompetencë të KKTU-së.

## **NENI 10**

Nenin 13 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

1. Certifikata e përdorimit lëshohet nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, brenda 30 ditëve nga depozitimi i aktit të kolaudimit dhe dokumentacioni të plotë shoqëruar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Lidhja e njësive individuale me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, lejohet vetëm pas paraqitjes nga zhvilluesi / zbatuesi i punimeve të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit,, përveç lidhjeve të nevojshme për punimet në kantier.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore apo Sekretariati teknik i KKTU, sipas përgjegjësisë në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, janë të detyruar që të depozitojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës certifikatën e përdorimit brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj, të shoqëruar nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- i. dokumentin e lejes së ndërtimit;
- ii. plani i vendosjes së objektit;
- iii. projekti arkitektonik i zbatuar “as built”

4. Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë të kërkuarit apo zhvilluesit.

#### **NENI 11**

*Në Nenin 14/3 “Përgjegjësia e zhvilluesit”, bëhen këto shtesa:*

- në pikën “2”, pas fjalëve “Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, shtohet togfjalëshi “dhe Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU”.
- në pikën “3”, pas fjalës “Bashkitë”, shtohet togfjalëshi “dhe Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.”

#### **NENI 12**

*Kudo në tekstin e këtij ligji, emërtimet:*

- “inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut” zëvendësohen me “Inspektoriatin vendor i mbrojtjes së territorit të bashkisë”;
- “autoriteti përgjegjës i planifikimit” zëvendësohen me “autoritetin përgjegjës i zhvillimit të territorit”;

#### **NENI 13**

*Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.*

### **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.**

Për zbatimin e këtij projektakti normativ ngarkohen autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

### **VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektakt normativ është përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila është ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projekt-ligj nuk krijon efekte financiare shtesë në buxhet. Ndryshimet e propozuar janë të aspektit teknik dhe procedural.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**DHE**

**MINISTËR**

**Belinda Balluku**